

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2008

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E hënë, 9 qershor 2008

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkollat e mesme social - kulturore (artistike, koreografike, sportive)

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rretho **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10a	10b	11	12a
Pikët													
Kërkesa	12b	12c	12d	13	14	15	16	17	18	19	20	21a	21b
Pikët													
Kërkesa	21c	21d	22a	22b	22c	23a	23b	23c	24	25			
Pikët													

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Naim Frashëri****Bukuria**
(Fragment)

Do të këndoj bukurinë
 E të lëvdoj perëndinë,
 Perëndinë e bukurisë
 Q'i dha shije gjithësisë.
 Perëndia bukuroshe,
 Ty të falem e të lutem!
 Më vjen në gjë të të futem,
 O zonja përkëdheloshe,
 Që më je si mbretëreshë!
 Të keqen, o pëllumbeshë!

Kudo është bukuria
 Në qiej, në dhe, në hënë,
 Në diell, me shenjë, në yj
 Ndër lule, ndër drurë, ndër pyj.
 Çdo vend që të ketë zënë
 Atje çfaqet perëndia,
 Po këtu është e tërë
 Dhe ajo ti është bërë.

Do të shtrihem,
 Të venitem
 Si kandili kur s'ka vaj,
 Balt' e pluhur
 Do të bëhem
 Të më shkelnjë këmb' e saj.

E të prehem
 Duke puthur
 Atë këmbë pasandaj.

As më thua:
 Ç'ke me mua?
 Pse të dua, paskam faj?

Pse heq unë
 Hidhërimë
 A në vdekça, ti mos qaj;

Vdekja ime
 S'të prish punë,
 Haj, e zeza jetë, haj!

Për pyetjet 1-6 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Në trajtimin e temës së bukurisë dhe dashurisë, Naimi ndikohet nga filozofia: **1 pikë**
- A) humaniste.
B) iluministe.
C) panteiste.
D) ekzistencialiste.
2. Shprehja "kudo është bukuria" shpreh: **1 pikë**
- A) përsëritjen e bukurisë.
B) universalitetin e bukurisë.
C) përsosjen e bukurisë.
D) transformimin e bukurisë.
3. Fakti që bukuria shihet kudo, në strofën e dytë, shprehet me figurën: **1 pikë**
- A) e inversionit.
B) e shkallëzimit.
C) e enumeracionit.
D) e hiperbolës.
4. Pushteti i së bukurës shfaqet si: **1 pikë**
- A) adhurim.
B) solidaritet.
C) lumturim.
D) dëshirë.
5. Kë lëvdon Naimi për mënyrën e veçantë të shfaqjes së bukurisë? **1 pikë**
- A) Gruan.
B) Natyrën.
C) Perëndinë.
D) Njeriun.
6. Poeti vendos shenjën e barazisë midis: **1 pikë**
- A) bukurisë dhe dashurisë.
B) bukurisë dhe miqësisë.
C) bukurisë dhe natyrës.
D) miqësisë dhe dashurisë.

7. Lexo me vëmendje krijimin. Vëri një titull tjetër poezisë, që t'i përshtatet kuptimit të saj.

1 pikë

8. Dallo dhe rendit fjalët kyçe (të paktën tre) në këtë poezi, duke ruajtur kronologjinë e përdorimit të tyre.

3 pikë

9. Në poezi ka një pyetje retorike. Interpretu përdorimin e saj në funksion të motivit kryesor.

2 pikë

10. Në vargun: “*I dha shije gjithësisë*”, fjala shije është përdorur në kuptimin e parë apo të figurshëm? Si e kupton atë?

2 pikë

a) _____

b) _____

11. Zbulo elementet erotike në këtë poezi. A ndikojnë idetë filozofike të Naimit (platonizmi dhe panteizmi) në mendimin e tij mbi dashurinë dhe të bukurën? Argumento përgjigjen tënde.

4 pikë

PJESA II**Balzak****Evgjeni Grande**

(Fragment)

Fytyra plot nur, tiparet aq femërore, të cilat qejfet e jetës nuk i kishin lënduar dhe as prishur freskinë, u përngjanin vijave, që mezi shquhen në horizontin e largët të liqeneve të kredhur në qetësi. Kjo pamje e qetë dhe me aq shumë ngjyresa femre, ajo fytyrë e ndritur dhe e çelur, si lulja kur bulon, shprehte atë qetësi shpirti dhe atë ndërgjegje të pa cënuar, që ia shtonte hijeshinë dhe femërinë. Evgjenia ndodhej ende në pragun e jetës, në atë stad të saj, kur lulëzojnë iluzionet femërore. Në këtë moshë, kur nuk e njihte ende se ç' ishte dashuria, duke soditur veten në pasqyrë, ajo nuk mund të mos mërmërinte: “A nuk do të m'i hedhë sytë, vallë? Mos jam aq e shëmtuar sa nuk do të m'i hedhë?”

Pas kësaj hapi derën e dhomës, që të nxirrte në çardak dhe zgjati kokën se mos dëgjonte ndonjë zhurmë.

“Nuk po ngrihet,”- tha me vete, tek i zunë veshët të kolliturën e Nanosë, e cila vërdallosej nëpër shtëpi: fshinte, ndizte zjarrin, lidhte qenin dhe bisedonte me gjënë e gjallë në stallë. Aty për aty Evgjenia i zbrii shkallët dhe iu afrua Nanosë, që po milte lopën.

- Nano, xhanka ime, përveç kafesë, më përgatit dhe krem për kushëririn tim!
- Mirë, mirë, zonjushë, po duhej të ma kishit thënë dje,- iu përgjigj Nanoja, duke ia shkrepur të qeshurit. – Se unë vetë nuk bëj dot krem, de! Kushëriri juaj është i bukur, po, ai është me të vërtetë i hijshëm. Pa ta shikoje rrobën e natës prej mëndafshi të qëndisur me ar. Unë e pashë. Ka ca të brendshme të bardha, të holla si kota e zotit abat.
- E po, na bëj pite, atëherë, Nano!
- Po ku t'i gjej drutë për të nxehur furrën! Ku ta gjej miellin, gjalpin?- iu përgjigj Nanoja, e cila në cilësinë e kryeadministratorit të zotit Grande i jepte vetes ndonjëherë një peshë shumë të madhe para syve të Evgjenisë dhe të së ëmës së saj. – Mos duhet ta vjedhim zotërinë për të kremtuar ardhjen e kushëririt tuaj? Kërkojini ju vetë gjalpë, miell, dru, se kush e di... ndoshta mund t'ju japë, se ai babai juaj është. Ja tek po vjen për të parë si jemi me ushqimet.

Evgjenia vrapoi e llahtaritur për në kopsht, kur dëgjoi shkallët të dridheshin nga hapat e të atit. Kishte filluar të bëhej e turpshme dhe ndjente atë lloj turpi të veçantë, që na e sjell lumturia e na duket se, ndoshta, ç' kemi në zemër, është e pasqyruar në ballin tonë dhe mund ta lexojë tjetri.

E gjora vajzë, i vinte plasje tek e shihte shtëpinë ashtu të zhveshur, të rregulluar pa pikën e shijes. I shtohet marazi, tek e krahasonte me elegancën e kushëririt. Dhe aty për aty e ndjeu që diçka duhej të bënte për kushëririn e saj. Po çfarë? As vetë s'e dinte. E ku ta dinte? Ashtu e padjallëzuar dhe tepër e sinqertë siç ishte, ia dorëzoi veten natyrës së vet engjëllore pa pikën e mosbesimit, pa dyshuar as në përshtypjet dhe as në ndjenjat e përjetuara.

*Për pyetjet 13 -19 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

13. Fragmenti është pjesë e romanit, ku përshkruhet:

1 pikë

- A) fati real i një vajze të re.
- B) fati real i një familjeje.
- C) fataliteti i jetës në përgjithësi.
- D) fati i fëmijës dhe të rriturit.

14. Veçori kryesor e stilit të Balzakut këtu është:

1 pikë

- A) konçiziteti.
- B) befasia
- C) fragmentarizmi.
- D) proliksiteti.

15. Figura e zotit Grande karakterizohet nga:

1 pikë

- A) ligësia.
- B) dinakëria.
- C) kopracia.
- D) mosmirënjohja.

16. Veprimi, si element i subjektit, në këtë vepër shoqërohet nga lidhjet:

1 pikë

- A) shkak-pasojë.
- B) dëshirë- bindje.
- C) intrigë-hakmarrje.
- D) përballje-dënim.

17. Përdorimi i krahasimit: “*Si lulja kur bulon*” tregon:

1 pikë

- A) një lule të veçantë që rritet në Francë.
- B) hijeshinë e femrës, kur lulëzojnë iluzionet femërore.
- C) aludim për një shpërthim emocional, shkaktuar nga pakënaqësitë.
- D) ndryshimin e dukshëm midis femrës dhe natyrës.

18. Përgjigjet e Nanosë, kur Evgjenia i kërkon gatim të mirë, janë të mbushura me:

1 pikë

- A) inat.
- B) dashuri.
- C) humor.
- D) mendjemadhësi.

19. Evgjenia vrapon e llahtarisur në kopësht sepse:

1 pikë

- A) nuk donte ta shihnin miqtë, të veshur në atë mënyrë.
- B) kishte frikë nga i ati, pasi ishte zgjuar herët.
- C) i vinte turp nga mendimet që i shfaqeshin në fytyrë.
- D) kishte bërë një gabim që prishte punë në shtëpi.

20. Si dukej shtëpia e Evgjenisë? Gjej detajet me të cilat e ka përshkruar autori atë.

3 pikë

21. Shkruaj 4 fjali, ku në secilën të dalë në pah një tipar i Evgjenisë.

4 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

22. Balzaku është shkrimtar realist. Gjej tre veçori të stilit të Balzakut që dalin këtu.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

23. Duke përdorur përmbajtjen, shkruaj kuptimin tënd për secilën nga shprehjet e mëposhtme:

3 pikë

- a) do të m'i hedhë sytë _____
- b) i jepte vetes një peshë _____
- c) i shtoej marazi _____

24. Emrat: *mosbesim, lumturia, hijeshia*, janë emra konkretë apo abstraktë?

1 pikë

25. Shprehja: “*ç’kemi në zemër, është e pasqyruar në ballin tonë dhe mund ta lexojë tjetri*”, është shkëputur nga fragmenti. Cili është komenti yt për këtë shprehje, duke u ndalur në tiparet që i jep njeriut pasqyrimi i hapur i ndjenjave?

3 pikë
